L I G J
Nr.8041, datë 30.11.1995

PËR MIRATIMIN ME NDRYSHIME TË DEKRETIT NR.1274, DATË 9.11.1995 "PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7936, DATË 18.5.1995 "PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7609, DATË 22.9.1992 "PËR TARIFAT DOGANORE"

Në mbështetje të nenit 16 dhe 28 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese",

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Miratohet dekreti nr.1241, datë 5.10.1995 "Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7936, datë 18.5.1995 "Për disa ndryshime në ligjin nr.7609, datë 22.9.1992 "Për tarifat doganore", duke e ndryshuar paragrafin e dytë të nenit 1 si vijon:

"Pajisjet e ngrohjes e të gatimit me gaz, vajguri apo gazoil, të gatimit të kombinuar me gaz dhe energji elektrike, si dhe të gjitha llojet e bombolave që përshtaten me to, përjashtohen nga taksa doganore".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 9.11.1995.